



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1852 prot

Ballsh, më 21.04.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 24 datë 21.04.2026

PËR
“MIRATIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR TITUJT
VENDORË TË NDERIT, EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE,
TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E
BASHKISË MALLAKASTËR.
-KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Bazuar ne nenin 8, nenin 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/a dhe b, nenin 54 pika a, k, l dhe m te ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”,(i perditësuar), ne Ligjin nr. 94/2022 date 22.12.2022 “Per Titujt e Nderit dhe Titujt Vendore te Nderit ne Republiken e Shqiperise”, ne VKM-ne nr. 861 date 10.12.2014 “Per miratimin e rregullave te hollesishme per funksionimin e Komisioneve Keshillimore per dhenien e Medaljeve dhe Titujt Vendore te Nderit ne Republiken e Shqiperise”

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e anëtarëve të komisionit këshillimor për titujt vendor të nderit ,si dhe emërtimin e rrugëve ,shesheve,territoreve,institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.
2. Komisioni i ngritur vepron si organ këshillimor ,dhe përbëhet si më poshtë:
Z.Fitim Baraj
Znj.Naime Dervishaj
Znj.Zinaida Ahmetaj
Znj.Rajmonda Veizaj
Znj.Burbuqe Shehaj
3. Komisioni Këshillimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij për një afat kohor 1 (një)vjeçar.Në rast nevojë ,me kërkesë të arsyetuar të komisionit,Këshilli Bashkiak mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

4. Komisioni zgjedh me shumicë votash Kryetarin dhe sekretarin e komisionit, të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e tij.
5. Komisioni organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e rregullores së brendëshme të funksionimit të komisionit këshillimor.
6. Pagesa për anëtarët është 5000(pesëmijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit.
7. Komisioni nuk mund të mbledhet më shumë se 1 herë në muaj.
8. Efektet financiare të pikës 6 të këtij projekt-vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë.

Konceptoi: N.Sakaj

Miratoi: M.Shehaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

